



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

viti shkollor 2011/2012

TESTI 1

GJUHË SHQIPE

UDHËZIM PËR PUNË NË TEST

Testin të cilin duhet ta plotësosh i ka 20 detyra, kurse për punë janë parashikuar 120 minuta. Secilën detyrë së pari lexoje me kujdes mendo për këtë se çfarë kërkohet në të. Së pari zgjidhi ato detyra të cilat janë më të lehta për ty, e më vonë zgjidhi ato detyra të cilat për ty janë më të vështira.

Lexoje me kujdes tekstin e secilës detyre, sepse në të është shpjeguar në çfarë mënyre duhet të përgjigjesh. Në detyra prej teje kërkohet të rrethosh shkronjën para përgjigjes së saktë, t'i bashkohësh pjesët e përgjigjes, të shkruash diçka etj.

Gjithnjë përdor emërtimet e plota me rastin e zgjidhjes së detyrave, shkurtesat nuk janë të lejueshme (psh., duhet të shkruash: rrethanori i vendit, e jo rr.v.).

Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shëno asgjë, ajo është hapësirë në të cilën shënohet numri i pikave.

Në këtë dhe në faqen e fundit mos shkruaj asgjë.


Testin duhet ta plotësosh me **stilolaps**. Gjatë punës mund të përdorësh lapsin grafit dhe gomën. Detyrat zgjidhi së pari me laps grafit sepse kështu ke mundësi që, nëse e vëren gabimin, këtë gabim ta korrigjosh.

Para se ta dorëzosh testin, verifiko përgjigjet tuaja edhe njëherë, e pastaj të gjitha përgjigjet shkruaji me stilolaps.

Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps grafit nuk do të pranohet, por as përgjigjja të cilës i është hequr vizë dhe e cila është korrigjuar me laps kimik.

Nëse e mbaron testin më herët, dorëzoja testin arsimtarit kujdestar dhe dil ngadalë që të mos i pengosh shokët.

Të dëshirojmë sukses në provim!



1. Lexo vjershën dhe thuaj çfarë teksti është:

Vrull

Zogj të bukur këndojnë me hare,
 Po zemra do t'më plasë mua në gji.
 I helmuar e shkoj jetën te ky dhe,
 Mërzitem në katund, në vetmi.
 Hapet përpara meje deti i shkëlqyer,
 Që zgjon në trutë e mi mendime shumë,
 E shqetësimi zemrën time çjerr,
 Aq sa vetëm pushoj kur bie në gjumë.
 (...)

Zef Serembe

- a) letrar
- b) joletrar

Rreth shkronjën para përgjigjes së saktë.

2. Kapitulli ose pjesa përmbyllëse e një vepre letrare, ku jepet zgjidhja e veprës a përfundimi i ngjarjeve, që shtjellohen në të ose flitet për fatin e mëtejshëm të personazheve dhe pasi të ketë kaluar një kohë që nga ngjarjet e treguara, quhet:

- a) Përmbajtje;
- b) Kapitull;
- c) Parathënie;
- d) Epilog.

3. Fjalitë e poshtëshënuara lexo dhe të njëjtat shkruaji drejt dhe pa gabime duke i përdorur shenjat e pikësimit.

1. Artan te kujtohet çme the naten e pare kur erdhe ne fshat.

2. Çdo vije e fytyres cdo levizje e dores cdo fjale cdo hap i Skenderbeut tregonte njeriun e veprave te medha.

4. Autori 1

Para një muaji është berë një ankete me qytetaret e komunës mbi problemet e shëndetësisë. Gjate anketimit edhe konstatuar se 60 % te qytetareve nuk kane njohuri mbi rrezikshmërinë qe mund te i kanosej shëndetit nga rrethanat e ndryshme. Nga kjo shihet se pjesa tjetër e të anketuarve ku 40 % e dinë apo nuk dinë rreth pasojave që mund të shkaktojë ndotja e ambientit, nga lëshimi i gazrave te makinave hedhja e mbeturinave apo...

Autori 2

Numri më i madh i qytetarëve kanë deklaruar, se jetojnë në një vend dhe në një ambient ku ndotja është e një shkalle mjaftë të larte. Pakënaqësitë dhe shqetësimet e tyre po I paraqesin gati për çdo dite. Mirëpo mjerisht me problemet e qytetareve- thuhet se nuk qanë kokën askush.

Shqetësimet e tyre gati për çdo dite po rriten dhe vetëm pritet momenti për një radikalizëm te qytetareve. Përkundër ankesave të qytetarëve, pushtetarët nuk po gjejnë kohe qe te merren me shqetësimet e qytetareve të shqetësuar.

Nga tekstet e lartshënuara trego se cili autor ka paraqitur shqetësimin më të madh.

a) Autori 1 është më i shqetësuar se autori 2

b) Autori 2 është më i shqetësuar se autori 1

c) Te dy autoret janë të shqetësuar

5. Ne ekskursion

Nxënësit e klasës se peste javën qe vjen do te bëjnë një ekskursion. Ata para se të nisen do të diskutojnë ku do të shkojnë.

Arta: - Shkojmë në Prishtinë?

Beni: - Në Prishtinë ishim herën e kaluar, shkojmë ne Brezovicë.

Iliri: - Çfarë mund të shohim në Brezovicë?

Beni: - Brezovica ka bukuri të rralla, andaj atje mund edhe të rrëshqasim me ski. Përveç tjerash atje ekziston edhe hoteli ku mund të flemë.

Arta: - Po besa, Brezovica për mua është vend i mrekullueshëm .

Të gjithë: – Mirë, kështu do të bëhet, do të shkojmë.

Lexo tekstin e lartshënuar dhe dallo argumentet.

6. Si shkruhet një letër zyrtare?

Instituti i Gjuhësisë dhe Letërisë

Rruga “Naim Frashëri”,

Nr. Tiranë

Tel: Fax.....

E-mail: _____

Përgjigjuni në pyetjet:

Ku shkruhen letrat zyrtare?

Çfarë shkruhet nën titullin?

Çfarë shkruhet në mbyllje të letrës?

7. Shkruaj me shkronja këta numra:

XXI _____

37 _____

11 _____

1980 _____

8. Blina mbeti pa folur shikonte hajrin që i jepte ferces para dhe mbrapa aq e merzitur kjo punë sa që me në fund i lut Hajris t'ia edhe asaj pak fercen me të cilën duhet të pastrojnë dhomen. Shembullin e lartshënuar lexoje dhe shkruaje sipas normave drejtëshkrimore.

9. Vajza ishte zhdukur dhe shoku për karshi nuk donte që të kthehej nga unë. Mbi tryeze qëndronte pakoja e çuditshme që la ajo dhe unë nuk guxojta të shikoja ç'kishte atje brenda... Me kujtohet kur isha i vogël dhe derisa po loznim në oborr me vajzën e fqinjës... Që të dy ishim të vegjël... Ajo, në atë kohë kur ishim të vegjël, më tha papritmas "ti je i çmendur", më shikoi trishtueshëm dhe iku me vrap... Kaluan vite të tëra dhe vajza nuk u duk, ndërsa unë mbeta me kujtime e fëmijërisë dhe vazhdova ta jetoja jetën si me prindërit - thua se nuk kishte ndodhur asgjë edhe pse sot e kësaj dite mendoj se në mes nesh kishte diçka, por kurrë nuk mundem t'ia themi njëri - tjetrit.

Lexo tekstin e lartshënuar dhe përgjigju se çfarë teksti është:

a) Tekst informativ

b) Tekst narrativ

c) Tekst argumentues

10. O BJESHKE TE LARTA, BJESHK KU JUVE MOS JU THENCIN! DUSHK E BAR NDER JU MOS DALTE KURRE! SHTATE OMERE BIJE KAM PASUR E TE SHTATE KETU KANE RENE. JU FALEM, O ZOGJ TE MALIT, MOS KENDONI KURRE KETEJ, SE JU DEGJON OMERI : ESHTË I RI E MALLENGJEHET FORT.

-Fjalitë e mësipërme shkruaji me shkronja të dorës në vizat e dhëna.

11. Lexo fjalitë e mëposhtme dhe nënvizo theksin:

E mrekullueshme! E pabesueshme! – foli një grua.

Erdhi Skënderi dje?

- 12.** Lexo me kujdes fjalët e mëposhtme dhe shëno theksin:
Hidhnin,
Peshkatarët,
Rrjetat.
- 13.** Nënvizoi kallëzuesin në fjalitë e mëposhtme:
Tek buron uji i ftohtë dhe fryn veriu në verë.
Tek i fryn bariu fyellit, tek kullosin bagëtia.
Me çka është shprehur kallëzuesi?
- 14.** Lexo fjalët e poshtëshënuara dhe trego(shkruaji) se cilat fjalë kanë të shprehur diftongun ua.
P.sh: Diell, dheu, fyell, grua, luaj, ftua, vëllai, luan
- 15.** Fjalët e poshtëshënuara ndaj në rrokje :
P.sh: ura, kodra, lexoj, i mirë, njëri; _____, _____, _____,
_____, _____
- 16.** Lidh me vijë titujt e veprave me autorët e tyre. Një titull është i tepërt.
- | | | |
|---------------------|---------------------------|--------------------------|
| | <i>Luli i vocërr</i> | |
| Migjeni ----- | <i>Kështjella</i> | |
| Naim Frashëri ----- | <i>Andrra e jetës</i> | |
| Petro Marko ----- | <i>Malësorja</i> | |
| Ismail Kadare ----- | <i>Këngët e Sibilave</i> | <input type="checkbox"/> |
| Ndre Mjeda ----- | <i>Shpella e piratëve</i> | |
| Nazmi Rahmani ----- | <i>Bagëti e bujqësia</i> | |
- 17.** Poezia “Gjuha shqipe” e autorit Gjergj Fishta i takon poezisë:
a) së shkruar artistike;
b) popullore;
c) epike.
- 18.** Durrësi shfaqej para meje përmes drithërimës se hijes se gjate te tendosur skutave te nje luginë deri poshtë gishtërinjve mbrojtës të maleve...
Shqipëria me afrohet gjithnjë e me pranë, teksa unë i nder duart plotë përgjërimit drejt saj. E atëherë nga thellësia e qenies sime ngrihen me ngulçim copëzat e asaj kënge që kam dëgjuar në fëmijëri nga goja e prindërve të mi të trashëguar brez pas brezi.
- O e bukura e More
që kur të lashë
e më nuk të pashë!...
-
- Këta njerëz të drobitur, më vështrojnë me sy të trishtë dhe besoj përkohësisht, larg zakoneve krenare që kanë arritur në mënyrë të pabesueshme deri të në, arbëreshet...
Dhe atëherë nis të ëndërroj me bindjen që, kur të vijë sërishmi këtu, njerëzit e gjakut tim do ti gjej të lumtur në tokë të fisme të të parëve të mi që po ndjen flladin e lirisë, pas një shtypjeje të gjatë gjysmë shekullore.

Lexoni me kujdes këtë pjese të shkëputur dhe tregoni se nga cili tregim është marrë:

- a) Ujku (Dritero Agolli)
- b) Kthimi në mëmëdheun e te pareve te mi (Konstatino Marko)
- c) Klithmë (Anton Pashku)

19. Në vijat përkatëse përball veprave të lexuara nga lektura shkollore shkruaj emrin dhe mbiemrin e autorit.

- 1. Malësorja.....
- 2. Nita.....
- 3. Djaloshi me dekorate.....
- 4. Robinson Kruzo.....

20. a) Dheu m'ka mlue, fat s'I qita vedit
po s'mora Tanushen e krajlit
E une Tanushen vet e ko pa
kur kena pas besë me krajli
gja ma t'mirë s'sheh njeriu ne këtë qiell !

b) Te falem ty , o gjuhë-shkëmb
me rrënjët thelle ne shkëmbinj
qe cave qiellin kur të të vrenjt
dhe shembe bisha e shtërpinj
po mbete prape
shkrepe e shtëng.

Lexo këto dy strofa dhe trego se cila strofë është shkruar në gjuhën letrare.

a) _____

b) _____

Rezultati në testin e gjuhës shqipe

Vërejtje: Nxënësit NUK e plotësojnë këtë faqe!
Këtë faqe e plotëson Komisioni!

Numri i përgjithshëm i pikave

		,	
--	--	---	--

Komisioni:

- _____
- _____
- _____
- _____

Numri i pikave për secilën detyrë.

Numri i detyrës	E pplotësuar	0 pika	0,5 pikë	1 pikë
1.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
15.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
18.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Shkruaj ✕ në vendin përkatës.

Numri i identifikimit (Shifra e nxënësit)	
Shkolla	
Vendi	
Emri dhe mbiemri i nxënësit	